



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Komunikim Ndërkulturor

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione/30 seminare

Viti , semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në "Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh"

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Lënda Komunikim Ndërkulturor ka karakter teorik dhe praktik, duke marrë rëndësi të veçantë në një botë globale ku individi përballet me sfidën e tejkalimit të vizionit etnocentrik dhe të përfshirjes së tjetrit si subjekt dialogu. Ajo lidhet ngushtë me çështje të kulturës bashkëkohore, ndërveprimin e kulturave, grupeve dhe etnive të ndryshme, si dhe me aftësinë për reflektim, dialog dhe tolerancë ndaj diversitetit. Lënda trajton tema mbi identitetin, emigrimin, akulturimin dhe transformimin kulturor, duke e parë komunikimin ndërkulturor si kusht të domosdoshëm për paqen, ekonominë, teknologjinë dhe ndërgjegjësimin etnik.

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Të ketë një vizion për komunikimin ndërkulturor si mjet integrimi
2. Të kuptojë se kontekstet shoqërore dhe politike përcaktojnë marrëdhëniet personale e kolektiv njohë se kulturat nuk janë të pandryshueshme dhe homogjene por hibride dhe dinamike

Rezultate të pritshme:

1. Të shpjegojë konceptet themelore të kulturës, ndërkulturës dhe diversitetit kulturor
2. Të analizojë dhe interpretojë fenomenet e identitetit, emigrimit, akulturimit dhe transformimit kulturor në kontekstin bashkëkohor
3. Të zhvillojë kompetencë ndërkulturore në gjuhën B, duke komunikuar në mënyrë të efektshme dhe të përshtatshme në situata shumëkulturore
4. Të aplikojë mendimin kritik dhe analitik në vlerësimin e marrëdhënieve ndërkulturore dhe ndikimit të tyre në paqe, ekonomi, teknologji dhe zhvillim social Të reflektojë në mënyrë kritike mbi rolin e komunikimit ndërkulturor në kontekstin e globalizimit dhe komunikimit turisti